



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 761/19prot.

Datë 22.04.2026

V E N D I M
Nr. 533 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datë 22.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 479/2026, datë 08.04.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “ADD GROUP” ShPK me *NIPT* L81722022V, Adresa: Rr. “Bulevardi Nënë Tereza”, Nr pasurie 9/22, Kamëz.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me *Nipt* J62426002Q, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi 4 Heronjtë, Vlorë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F, me *Nipt* L81722022V, Adresa: Rr. Ali Pashë Gucia, Godina nr.5, L. Katund i Ri Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me *Nipt* J62426002Q Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr. 479/2026, datë 08.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ADD Group” ShPK në lidhje me pretendimet për skualifikimin e operatorin ekonomik “Ervin Luzi” PF në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK në lidhje me shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të KSHA-së për operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë pjesërisht Vendimin nr.5040/1Prot., datë13.03.2026 të KSHA-së, mbi skualifikimin për shtojcën 9, operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F, sipas konstatimeve të mësipërme.
4. Ngarkohet zyra e financës të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “ADD Group” ShPK.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr. 7085/1 Prot., datë 15.04.2026 protokolluar me tonën me nr. 761/16, datë 20.04.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 479/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr. 7085/1 Prot., datë 15.04.2026 protokolluar me tonën me nr. 761/16, datë 20.04.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 479/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar si edhe nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka lënë të kualifikuar operatorin ekonomik “Ervin Luzi” P.F duke shfuqizuar vendimin e KSHA-së për procedurën së prokurimit objekt ankimi, në zbatim të vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë. ka zbatuar vendimin Nr. 479/2026, datë 08.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74979-02-02-2026, me objekt “Blerje Tonerash për Vitin 2026”. me fond limit 1,666,380 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

